



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**MINISTRI**

Rruga: "Durrësit", Nr. 23, AL- 1001, Tiranë – SHQIPËRI

[www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al)

Tel: 00 355 4 226 307

5132  
Nr. ... Prot.  
Tiranë, më 02.09.2009

**U D H Ë Z I M**

Nr. 24, datë 02.09 2009

**P Ë R**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 30, DATË 26.9.2007**  
**"PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT**  
**QË DUHET TË PARAQESË SUBJEKTI JURIDIK, PËR HAPJEN E**  
**NJË INSTITUCIONI PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË OSE PROGRAMEVE TË**  
**STUDIMIT, NË CIKLIN E PARË**  
**DHE CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 44, të ligjit nr. 9741, datë 21.05. 2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar

**U D H Ë Z O J :**

Në udhëzimin nr. 30 datë 26.09.2007 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Titulli i udhëzimit bëhet si më poshtë vijon:

"Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit që duhet të paraqesë subjekti juridik, për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë, ose programeve të studimit në ciklin e parë, ciklin e dytë dhe ciklin e tretë të studimeve, si dhe të programeve të studimeve jouniversitare, të natyrës profesionale".

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me përmbajtje si më poshtë vijon:

1/1. "Propozimin për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë të Doktoratës, si rregull, mund ta bëjnë vetëm institucionet private të arsimit të lartë, të cilat janë licencuar



dhe kanë marrë lejen përkatëse nga ministri i Arsimit dhe shkencës, për programe studimi të ciklit të parë dhe programe studimi të ciklit të dytë.

Propozimi për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë-të doktoratës duhet të jetë në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 864, datë 5.12.2007, "Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore "Doktor" dhe udhëzimin e ministrit nr. 5, dt. 22.01.2008, "Për përcaktimin e standarteve akademike të nevojshme për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit të doktoratës si dhe të elementëve bazë sipas të cilave institucionet e arsimit të lartë duhet të përgatisin rregulloren përkatëse.

Në të të përcaktohen edhe kushtet që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore "Doktor" në përputhje me VKM nr. 864, datë 5.12.2007, të cituar më sipër".


3. Pikës 6, të kreut I dhe pikës 4, të kreut II të udhëzimit, i shtohet fjalia si më poshtë vijon:

"Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), vlerëson vetëm dokumentacionin e dërguar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës".

4. Në pikën 7, të kreut I dhe në pikën 5 të kreut II, shprehja "brenda 6 javëve" bëhet "brenda 4 javëve".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

MINISTRI



FATOS BEJA

